

DOLOREZA PETRELA RRAPOLLARI

BOTA E MBUSHUR ME AJER

BOTIMET TOENA

DOLOREZA PETRELA RRAPOLLARI

BOTA E MBUSHUR ME AJER

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960726

© AUTORI dhe BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “Muhamet Gjollesha”, nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Në vend të parathënies

Ajer!

Ti je era e butë që më mësoi që dashuria nuk ka moshë.

Ti ke një erë të ëmbël që më mësoi që të gjitha aromat mbajnë erën e dashurisë.

Ti je fllad që më përkëdhel butë gjithë qenien time.

Ti çdo ditë më përcjell mesazhe që kurrë në jetë si kam ndier.

Ti që u rrite para kohe dhe unë që çdo hap tëndin ta drejtova me aq kujdes e butësi që ti të mos vriteshe kurrë.

Ti që më dhe për herë të parë titullin më të ëmbël në botë “Gjyshe”.

Nëse ndonjëherë jeta të sjell erëra të forta hape këtë libër.

Ndoshta nuk do gjesh përgjigje për gjithçka, por do të gjesh një gjë që nuk do të ndryshojë kurrë. Dashurinë time për ty.

Unë të kam parë, të kam kuptuar, të kam dashur në çdo version tëndin.

Nëse një ditë do të lexosh këtë libër me sytë e një gruaje dua të dish vetëm një gjë:

Nuk kam dashur të shkruaj historinë tënde. Kam dashur të ruaj mënyrën sesi të kam parë.

Të kam parë me sytë e një gjysheje që të ka numëruar buzëqeshjet, ka ndier heshtjet e tua dhe ka besuar gjithmonë te vajza që do bëhesh.

Nëse ndonjëherë do harrosh sa e fortë je, hape këtë libër!

Mes faqeve të tij do më gjesh gjithmonë duke të thënë:

Vazhdo të ecësh përpara. Era nuk është armiku yt, përkundrazi, ajo do të mësojë të fluturosh lart.

Kur unë mos të jem, ti do nxjerrësh librin nga biblioteka. Ndoshta faqet do të jenë zverdhur pak. Do ta hapësh dhe do dëgjosh zërin e zemrës time, do lexosh shkronjat e shpirtit tim.

Disa lenë trashëgimi stoli, disa lenë trashëgimi shtëpi. Por ka edhe trashëgimi që rrallë gjendet:

Një libër ku një fëmijë gjen veten.

Një ditë kur duart e mia të mos mund të përqafojnë ty dhe E'Duan aq fort sa tani, fjalët e mia do ta bëjnë këtë për ju.

E'Dua do të më gjejë në Pse-të e saj, ndërsa ti do më gjesh në “Botën e mbushur me Ajer”.

Sa herë do t'i hapni këto libra aty do të gjeni shpirtin tim, zërin tim dhe do ndieni aromën e përqafimit tim. Do ta kuptoni që keni patur një gjyshe që nuk u dhuroi vetëm lodra e veshje, por u dhuroi diçka që nuk vjetërohet kurrë:

KUJTESËN E DASHURISË.

Kush është Ajer

Ajo jeton në një botë që ndonjëherë duket shumë e qetë e ndonjëherë shumë e zhurmshme.

Unë e shoh atë përtej shpërthimeve dhe heshtjes.

Ka ditë kur qesh fort, vrapon, flet pa pushim dhe mbush çdo cep me dritë. Por ka edhe ditë kur mbyllet në heshtje si një dritare që nuk do të hapet.

Askush nuk e kupton plotësisht pse zemra e saj ndryshon si koha. Jam e bindur që as vetë ajo nuk e kupton.

Kur mërzhitet fjalët i dalin si erë e fortë dhe kur stuhia kalon ajo afrohet ngadalë, përqafton fort, puth me mall sikur do të thotë pa fjalë.

“Mos u largoni nga unë!”

Është rebele deri në kufijtë e të mundurës. Ka një botë që askush nuk arrin t’ia zbulojë. Sa herë mbyllet në vetvete bota e saj kërkon të zbulojë por pa rënë në sy. Ajo zbulon, flet, qesh dhe qan në heshtje.

Ajo flet me shikim, reagon vetëm me gjepte,
kur ngre zërin, faji nuk bie më mbi të.

Brenda saj jeton një stuhi e vogël. Ajri nuk
duket kurrë i njëjtë me Ajerin. Disa ditë është
e lehtë si puhizë e disa ditë fryn fort brenda
zemrës së saj.

Ajo ka dy shtëpi, dy jastëkë ku fle, dy dritare
nga ku shikon shiun, dy oborre nga ku flet me
shoqet dhe i vidhet njerëzve mos t'i dëgjojnë
sekretet.

Në njërën shtëpi le lodrën e saj të preferuar,
në tjetrën rrobat që i pëlqejnë më shumë.

Por zemrën e saj të vogël nuk di ku ta lerë,
kështu që e merr gjithmonë me vete.

Zemra e saj e vogël është e mbushur plot me
dashuri për të gjithë.

Bashkë me zemrën, ajo gjithmonë merr me
vete motrën e saj të vogël E'duan, që e ka pjesë
të shpirtit dhe që jetën e saj nuk e kupton dot
pa të.

Ajo kujdeset për motrën me një dashuri si
prej nëne, shikon përreth mos ajo rrezohet, mos
bëhet pis, mos qan dhe bota me motrën i duket
më e bukur më e paqtë, më me ngjyra.

Megjithëse motra është trazovaçe dhe
ndonjëherë e mërzit, ajo përpiqet të kalisë

durimin dhe të mos e mërzisë atë, madje deri diku t’ia plotësojë tekat..

Kështu nis historia e një vajze të vogël me një botë të madhe, një botë e mbushur me “Ajer”.

Kapitulli

1

Kur Ajer hyri në jetën time

A ka poet, apo autor librash, që mund të përshkruajë më bukur se sa çfarë janë ato krijesa aq të ëmbla e të pafajshme?!

Jo, nuk ka.

Kur mora lajmin se do të bëhesha gjyshe, brenda vetes m'u përzien shumë mendime.

Duke qenë një natyrë sportive, e lirë, e shëtitur... mendova se tani e tutje nuk mund të kisha jetën e mëparshme, pasi obligimet dhe detyrimet do t'i kisha prezent në çdo çast.

Të them të drejtën, u mërzita, sepse mendoja që nuk do të merrja më frymë. (Nuk e kisha ndier ende se Ajeri që më dha ajër do të më mbushte mushkëritë).

U mërzita, sepse atributi “gjyshe” mendoja që do të më bënte më të moshuar, më të rrudhur, më pak të qeshur, me më pak energji për jetën.

Shpesh i thosha vajzës që nuk doja të më thoshte “nona”. Dua të më thërrasë me emër.

Kisha gabuar në perceptim.

Si njeri që kam marrë vendime për shumë gjëra në jetë, mendova se do të ndikoja te prindërit e saj për t’i vendosur emrin.

Prapë kisha gabuar.

Kishin vendosur t’i vinin emër shqiptar, por i vjetër për kohën.

Emrat e fëmijëve (jo vetëm të vajzave të mia) kanë qenë pasioni im.

I them vajzës me këmbëngulje dhe me një lloj inati që, nëse ia ve emrin ashtu si keni vendosur, nuk të të flas më me gojë.

Vajza, me një buzëqeshje të qetë, më thotë:

- Do ta quajmë “Ajer”. Kemi bashkuar emrat Ajlin dhe Erion.

Gëzimi ishte i papërshtatshëm.

Më ngjiti ai emër.

Ashtu, si njeri i vrullshëm, kur Ajer nuk kishte dalë ende në dritë, e konsolidova emrin në formë “tattoo” - je në krahun tim.

Tashmë vendimi kishte marrë formën e prerë.

Ditët kalonin dhe ankthit tim po i vinte fundi.

Ishte një ditë gushti me diell që ngrohte aq nxehtë, saqë shpirti im ishte kthyer në një

vulkan, llava e të cilit nga çasti në çast do të shpërthente.

Kalimtarët në rrugë nxitonin për në angazhimet e veta dhe i kisha zili.

Unë, me ankthin e një nëne, këmbët i hidhja çapitur dhe, sa më shumë afrohesha të dera e maternitetit, aq më shumë ecja “kuturu”.

Ecja dhe provoja gjithçka mund të provojë një njeri që ka shumë arsye të lumturohet, po që ende nuk di si do të jetë vërtet ajo ndjenjë.

Emocioni dhe merakun që vajza do të futej në operacion, më kishin venitur çdo gjë.

Si luaneshë, falë muajit kur kam lindur dhe shenjës zodiakale që i përkas (pa pyetur për rregulla dhe orare) kam përjetuar çdo sekondë të daljes në jetë të asaj krijese, prapa derës së asaj dhome ku po lindte një krijesë, e cila po më jepte edhe mua një tjetër drejtim në jetë.

Mbështetur pas derës ku kryhej operacioni, prisja me padurim çdo zhvillim.

Isha e gatshme të futesha brenda në sallë që t’i jepja forcë, buzëqeshje (mbi të gjitha, jetë nga jeta ime) asaj vajze që do të më dhuronte një perandori të tërë.

Kapitulli *2*

Një vajzë me erë të ëmbël në flokë

Tingulli i parë i një të qare, si një melodi e bukur, do të ngulitej në veshët e mi e do të bënte që venitja e asaj dite të merrte ngjyra të forta, ndriçuese dhe aq domethënëse.

Nga shpirti, si pa kuptuar, më doli shprehja: “Shpirti i nënës...”, postulat që do të më shoqërojë krenarisht derisa të kem frymë.

E harrova vajzën time ato çaste.

Ëndrrat morën krahë dhe fluturuan duke mbushur qiellin me ngjyra të arta e vezullime dritash.

Kur e pashë në krahët e infermieres, e cila kishte tri bebe që po i dërgonte për vizitat rutinë te Pediatria, me shpejtësi më lindi pyetja:

- Kush është imja?

Kalova para syve të tre engjëjt në krahët e saj e intuira nuk gaboi. E njoha.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Të thërret gjaku.

Iu afrova e i mora erë.

Ishte aroma më e ëmbël që kisha shijuar ndonjëherë: erë shpirti, erë jete, era e shpirtit tim, që ma kishte sjellë si një dhuratë pa çmim.

Pas atij emocioni të fortë, kur ende nuk kisha mbledhur veten, me barelë, para syve të mi më shfaqet ajo, vajza ime e shtrenjtë, e cila kishte marrë pamjen e një nëne.

- Mam, - më thotë si në belbëzimet e veta të para.

- Po, bir, - i them me zë të dridhur.

Mezi e ngre dorën dhe më shtrëngon timen.

Dora ishte akull e unë, e trembur, pyes mjekun:

- Pse është e ftohtë vajza?

Mjeku, me qetësi dhe pak me shaka, më thotë:

- Ty kush të ka futur këtu?! Nuk lejohet.

- Unë?! Nuk desha vetë, sepse, po të doja, hyja edhe në sallë.

Ai qesh, më shtrëngon krahun dhe më thotë:

- Vajza është shumë mirë. Thjesht, është e emocionuar. Domosdo: është bërë nënë. Ka sjellë në jetë një mrekulli.

Ecja rrugëve të Tiranës atë ditë dhe nuk di pse qyteti ku kisha lindur, ku isha shkolluar e kisha ëndërruar për jetën, kishte marrë tjetër kuptim.

Shikoja njerëzit që ecnin të shkujdesur dhe nuk di si përmbahesha e nuk bërtisja me të gjithë forcën e shpirtit:

- Unë jam bërë “nona”; unë kam puthur një engjëll; unë kam marrë në krahë një mbretëreshë; unë jam mbushur edhe me “Ajer”, jo veç me ajër...

Jeta ime mori një ritëm tjetër. As vetë nuk e kuptova si ndryshova ashtu. Nga ajo grua e lirë, e dashuruar me jetën, muzikën, futbollin, udhëtimet, e lirë në shaka, e lirë në perceptimin e gjërave, një qenie sa një grusht më bëri të ndryshojë këtë ritëm.

Çdo ditë zgjohesha dhe mendja aty, ecja për në punë dhe mendja aty, nxitoja për në shtëpi dhe hapat nxitonin ta shikoja, të ndiqja çdo lëvizje të saj, çdo buzëqeshje, çdo ngashërim dhe m'u krijua ideja se po rritesha me atë.

Ajo krijesë solli tek unë një ëndërr që jeta nuk ma kishte plotësuar asnjëherë deri në ato momente.

Ajo krijesë bëri që unë të mendoj se çfarë kishte ndodhur në të kaluarën nuk kishte patur kurrsesi rëndësinë e kësaj dite.

Ajo krijesë solli në familjen time një buzëqeshje për t'u admiruar.

Ajo krijesë bëri që edhe orenditë e shtëpisë të kishin më shumë ngjyra e më shumë shkëlqim.

Ajo krijesë ishte preludi i gjithë udhëtimit tim jetësor.

Kur u bëra nënë nuk gjykova kurrë kështu.

Marrija e titullit gjyshe më bëri më të mençur dhe më të pjekur.

Ky titull më bëri që dashurinë ta shikoj në të gjitha dimensionet dhe fjala sakrificë mori kuptimin e vërtetë.

Kapitulli *3*

Ditët kur shtëpia mori frymë ndryshe

Ditët rridhnin, herë të qeta dhe herë të zhurmshme; herë të bukura dhe herë me ankth dhe Ajeri formësohej e merrte dritën e diellit e na ngrohte edhe ne.

Sa kujtime kam prej saj që nga dita kur më ka thërritur për herë të parë!

I thotë vajza:

- Kush është kjo?

Unë, sapo kisha hyrë në derë dhe silueta ime bëri që ajo (pavarësisht se nuk ishte më shume se 1 vjeç) të belbëzojë vetëm dy germa.

- No, - më thërriti.

Edhe sot e kësaj dite i kam ende në vesh ato dy tinguj të artë.

Ajo po merrte forma mrekullie dhe unë mbushesha me ajër lumturie. Ashtu topolake me doçkat e vogla, me shikimin e ëmbël por me një këmbëngulje për t'u patur zili. Ajo

vendoste vetë për çdo gjë. Ajo edhe shtëpisë i dha tjetër aromë. Ndryshoi çdo gjë. Po ajo që më habiti më shumë është se ekzistenca e saj më bëri edhe mua të ndryshojë. Nga një grua e pavarur, nga një grua në karrierë, shpeshherë në udhëtime, u ktheva me shumë krenari në një gjyshe si ato të përrallave.

Kapitulli *4*

Koha e batutave

Sapo kishte mbushur 3 vjeç, bashkë me Ajlin, më vijnë te shtëpia ime për vizitë.

Unë nuk ndodhesha aty dhe zhgënjimi i saj që nuk më gjeti prezent kishte qenë i madh.

Ajlin i tha për ta ngacmuar:

- Ka ik nona?! E shikon, nuk të ka xhan.

E mërzhitur prej vërteti, filloi dialogun me mëmën e saj.

Ajlin e nxiste që ajo të fliste dhe të nxirrte nga goja çfarë ndiente një fëmijë 3-vjeçar i zhgënjyer.

- Nonën do ta çoj në polici, - i kthehet mamit.

- Pse mi? - vazhdonte ajo dhe mezi mbante të qeshurën.

- Do ta çoj në polici, sepse është gocë e keqe, - i doli nga shpirti.

- Nona gocë e keqe?! - vazhdonte e ëma për t'i nxjerrë edhe më shumë.